



E SHQIPERISE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER**

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them.199/1327  
Dt. Rregj. 09.09.2014

Nr. Vendimi 231  
Dt. Vendimi 24.03.2015

**V E N D I M**

**"Mbi pushimin e gjykimit"**

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Shkoder, e perbere nga:

**Valbona Durraj – Gjyqtare**

Asistuar nga sekretare seance Borana Liti, sot me datë 24.03.2015, ora 11.30 në seancën përgatitore të çështjes administrative me nr.Rregj.Them.199/1327 dt. rregj.09.09.2014 që l përket palëve ndërgjyqëse:

**PADITËS:**

Lulzim Izet Karini, i datelindjes 01.09.1978, lindur ne Shkoder dhe me zotesi te plote per te vepruar. Me adrese prane avokat Lulzim Karini, rruga Don Bosko, Shkoder. Me nr tel 0692073488 dhe email; [avluli@yahoo.it](mailto:avluli@yahoo.it)

**TE PADITUR:**

1-Drejtoria Rajonale e Tatimore Shkodër përfaqësuar nga Zj.Brikela Rroji, e autorizuar për përfaqsim me autorizim nr 2240 prot dt.19.03.2015.  
2-Drejtoria e Apelimit Tatimor-pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë (në mungesë).

**OBJEKTI:**

1-Shfuqizimin e akteve administrative, perkatesisht shkrese e titulluar kthim pergjigje Nr 3170/1, date 08.05.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder, te lene ne fuqi nga Drejtoria e Apelimit prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve me shkresen nr 12516/1 date 11.08.2014 e titulluar Vendim i Drejtorise se Apelimit Tatimor .  
2-Detyrimin e Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder te fale gjoben dhe kamatvonese ne shumen totale 26.447 leke per periudhen tatimore 2006 03 (3 mujori i pare viti 2006) per Kontributet e Sigurimeve Shoqerore.  
3-Detyrimin e Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder te paguaje shpenzimet gjyqsore ose ti zbrese nga detyrimet e mia te ardhshme.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17,18, e vijues te ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe

funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", Neni 32 të K. Pr. Civile. Ligji Nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore", Udhezimit nr. 24 date 02.09.2008 te Ministrit te Financave pika 106.1.6, Ligjit Nr. 10418 date 21.04.2011 " Per legalizimin e kapitalit...." i ndryshur dhe konkretisht neni 23 pika a

Gjykata në seancën përgatitore, pasi dëgjoi përfaqësuesen e pales paditese që deklaroi se kërkon të heq dorë nga gjykimi, shqyrtoi dhe analizoi provat shkresore

VEREN se:

Pala paditëse Lulzim Karini i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi me objekt: Shfuqizimin e akteve administrative, perkatesisht shkrese e titulluar kthim pergjigje Nr 3170/1, date 08.05.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder, te lene ne fuqi nga Drejtoria e Apelit prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve me shkresen nr 12516/1 date 11.08.2014 e titulluar Vendim i Drejtorise se Apelit Tatimor .

Detyrimin e Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder te fale gjoben dhe kamatvonesë ne shumen totale 26.447 leke per nenin 2006 03 (3 mujori i pare viti 2006) per Kontributer e Sigurimeve Shpëtorë

Detyrimin e Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder te paguaje shpenzimet gjyqsore ose ti zbrese nga detyrimet e mia te ardhshme.

Në seancën përgatitore të datës 24.03.2015, pala paditëse tha se konform nenit 39/3 të ligjit 49/2012, kërkoj pushimin e gjykimit pasi do i drejtohet Gjykatës me një tjetër kërkesë padi.

Ne nenin 39 pika 3 të ligjit 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", parashikohet se gjykata vendos pushimin e gjykimit kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë.

Gjithashtu në nenin 201, paragrafi i parë i K.Pr.Civile, parashikohet se:

"Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjykimit. Edhe në nenin 299, gërma "b" të K.Pr.Civile, është parashikuar si një nga rastet e pushimit të gjykimit kur paditësi heq dorë nga gjykimi i çështjes.

Nisur nga sa sanksionohet në këto nene dhe nga sa rezultoi në gjykim, duke qënë se pala paditëse heq dorë nga gjykimi për shkak se do të drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor me një tjetër kërkesë padisë, gjykata çmon se çështja duhet pushuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 39/3 të Ligjit 49/2012

VENDOSI

Pushimin e gjykimit të çështjes.

Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë.

Kundër vendimit lejohet ankim brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

**Shkodër me datë 24.03.2015**

**SEKRETARE SEANCE**

Borana LITI



**GJYOTARE**

Valbona DURRAJ





VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË. 14.05.2015

KANCELARE

*B. Nurja*  
BLERTA NURJA

